

TLAS




Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

Gazeta TLAS

Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë

Nr. 1 2009

NUMRI TOTAL I CESHTJEVE NE VITE
Janar 1999 - Dhjetor 2008



Botimi i këtij materiali është mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) gjatë vitit 2008

Viti 2008 shënoi vitin e dhjetë të aktivitetit të TLAS dhe një tjetër vit të suksesshëm të dekadës së parë. Me ndihmën dhe mbështetjen e donatorëve, partnerëve, stafit dhe përfituesve të klientëve të tij, TLAS bëri hapa cilësorë në ofrimin e shërbimeve, në zgjerimin e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe në ndërmarrjen e nismave për përmirësimin e legjislacionit. Në kuadrin e riorganizimit të pandërprerë për t'ju përgjigjur nevojave dhe kërkesave të grupeve të synuara, për të përballuar vështirësitë dhe sfidat, TLAS i përqëndroi përpjekjet në zbatimin e një strategjie sa më efiçiente për ngritjen e fondeve, në mënyrë që të sigurohej vazhdimësia e aktivitetit të organizatës, të respektohej misioni dhe sigurohej cilësia e shërbimeve të ofruara për kategoritë më vulnerabël në Tiranë dhe rrethe të tjera të vendit tonë.



Tashmë, TLAS njihet në të gjithë Shqipërinë si një nga organizatat më serioze dhe më aktive në fushën e ofrimit të shërbimeve ligjore dhe atë të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

TLAS ofroi shërbime ligjore, shërbime paraligjore, aktivitete të *street law*, shërbimet e clinics, këshillimit ligjor nëpërmjet linjës telefonike, shërbimeve mobile, etj. Njëkohësisht, TLAS vazhdoi me zbatimin e aktiviteteve të tij në fushat e aktiviteteve të trainimit me punonjësit e strukturave shtetërore, ngritjen e kapac-



iteteve të organizatave që kanë si anëtarë grupet e synuara të TLAS si dhe me zbatimin e Programit të "Internship" nëpërmjet angazhimit të studentëve të Fakultetit të Drejtësisë në punët e përditshme të TLAS.

Duke marrë parasysh vështirësitë me të cilat është përballur TLAS, në sistemin gjyqësor dhe administratën publike, mund të thuhet se cilësia e shërbimit të tij ka qenë e kënaqshme dhe konkretisht gjatë vitit 2008, 92% e rasteve të trajtuara në rrugë gjyqë-

sore kanë qenë të suksesshme dhe 86 % e rasteve të trajtuara në rrugë administrative kanë qenë të sukseshme. Ndërmjet grupeve më të mëdha të përfituesve të TLAS kanë qenë pjesëtarët e pakicave, personat me pa aftësi fizike ose mendore, pensionistët, të papunët si dhe familjet e tjera me atë ardhura të pamjaftueshme. Gjatë vitit 2008, më tepër se 52,5 % e rasteve kanë të bëjnë me regjistrimin e lindjeve 22.3% me sistemin e përfitimeve shoqërore, 7,5% me mosmarrëveshje pronësi, rreth 15% me gjendjen civile, rreth 2% mosmarrëveshje pune, etj.

Edhe gjatë vitit 2008, projektet kryesore të TLAS kanë synuar rastet e regjistrimit të lindjeve të fëmijëve dhe të të rriturve, rastet për përfitim nga sigurimet shoqërore e shtetërore, raste të mosmarrëveshjeve të pronësisë, çështje të së drejtës familjare, nismat për draftimin e ligjeve të reja, programet e monitorimit, trainimi i punonjësve të administratës gjyqësore, asaj publike dhe OJF-ve.

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) e ka filluar veprimtarinë e tij në Janar të vitit 1999. Aktiviteti i TLAS gjatë vitit 2008 bazohet në projektin "Shërbimi Ligjor Falas për shtresat në nevojë" dhe është bërë i mundur në sajë të financimeve të CAFOD UK, (Fondi Katolik për Zhvillimin e Vendeve të Përtej Detit), Britania e Madhe, UNICEF, Programi për mbrojtjen e Femijeve i Kombeve të Bashkuara, SHC, Komiteti Suedez i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut; SOROS (Fondacioni i Shoqërisë së hapur për Shqipërinë); UNDP; USAID/ROLP, Ambasada Amerikane, Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci; Terre des Homes Tiranë; Partnerët për Fëmijët Tiranë; Benchmark Institute, San Francisco.

Kujdesi ndaj Komunitetit Rom ka qenë një nga prioritetet e TLAS gjatë vitit 2008. Përveç shërbimeve të drejtpërdrejta ligjore (ku vendin kryesor e kanë zënë regjistrimet civile, TLAS ka ofruar për pjesëtarët e këtij komuniteti, trajnime specifike me synim forcimin e kapaciteteve të or-



ganizatave të komunitetit rom; trainime me punonjësit e administratës gjyqësore për rritjen e aksesit në gjykatë të pjesëtarëve të këtij komuniteti; trainime me organizatat komunitare romë për të drejtat sociale dhe ligjore që ata gëzojnë dhe për mënyrën sesi mund të përfitohet nga këto të drejta. Gjithashtu, një numër i madh aktiviteteesh *Street Law* janë zhvilluar në zonat informale të banuara kryesisht nga ky komunitet.



Gjatë viteve 2007- 2008, TLAS filloi zbatimin e njërit prej projekteve më ambicioze, atë të hartimit dhe miratimit të Ligjit për "Ndihmën Juridike". TLAS angazhoi ekspertët më të mirë në Shqipëri në fushën e të drejtës civile, të drejtës administrative, të drejtës penale, menaxhimit dhe administrimit për hartimin e projekt-ligjit për "Ndihmën Juridike" në Shqipëri. Pas diskutimeve të shumta, komenteve dhe fushatave ndërgjegjësuese e lobuese të organizuara nga

TLAS në disa rrethe të vendit, projekt-ligji u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë si Ligji nr.10039, datë 22.12.2008. Ligji u dekretua nga Presidenti i Shqipërisë në datën 12.01.2009 dhe hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare. Tashmë Shqipëria përmes këtij ligji institucionalizoi sistemin e ofrimit të ndihmës juridike por shumë akte të tjera duhet të hartohen e miratohen në mënyrë që ky kuadër të plotësohet.


Më poshtë po japim disa statistika për rastet e trajtuara nga TLAS. Në fund të Dhjetorit 2008, numri i përgjithshëm i klientëve të TLAS që kishin përfituar shërbim paraligjor, ligjor dhe kliniks arriti shifrën 10236 nga të cilat 5945 janë raste paraligjore dhe 4291 janë raste ligjore. Vetëm gjatë vitit 2008, u shërbyen 1660 raste klientësh (956 raste paraligjore dhe 704 raste ligjore), duke përfshirë edhe 99 rastet e transferuara nga viti 2007. Gjatë vitit 2008 përfituan nga shërbimi i këshillimit ligjor nëpërmjet telefonit (shërbimi lawline) rreth 467

individë. Ky numër nuk përfshin numrin e këshillimeve që kanë përfituar këta personave nga paraqitja e tyre personalisht në zyrë, pasi ato janë llogaritur si shërbime të përfaqësimit ligjor. 744 raste ose pothuajse 44% e klientëve të rinj i përkasin komunitetit Rom në Tiranë, Elbasan dhe Fier, dhe shumica e tyre kanë përfituar regjistrimin e lindjes së fëmijëve, zgjidhje martesash, regjistrime të vdekjeve e raste të tjera.

TLAS edhe gjatë 2008 kryesoi me shumë sukses koalicionin e BKTf (Së bashku Kundër Trafikimit të Fëmijëve), koalicion prej 21 organizatash jo fitimprurëse që punojnë kryesisht në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes së fëmijëve nga shfrytëzimi, abuzimi e trafikimi. Në prezantimin e Raportit të Analizës, organizuar për këtë qëllim në Hotel Rogner mori pjesë edhe Kryeministri i Shqipërisë, Presidenti i UNICEF, Ambasadori i SHBA në Tiranë, e

Grafiku i mëposhtëm paraqet numrin e rasteve të trajtuara nga TLAS në vite.

NUMRI TOTAL I CESHTJEVE NE VITE
Janar 1999 - Dhjetor 2008





partnerë të tjerë të rëndësishëm. Pjesëmarrja në këtë Koalicion ka ngritur në një shkallë më lartë punën në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve vulnerabël, si një nga target grupet kryesore të TLAS.

Një nga aktivitetet më të mëdha të TLAS gjatë vitit 2008 ishte organizimi në Tiranë në Korrik 2008 i një tryeze të rumbullakët me punonjës të zyrave të gjendjes civile nga i gjithë vendi (340 pjesëmarrës), për rritjen e shkallës së perceptimit të ndry-

shimeve në ligjin e gjendjes civile për regjistrimin e lindjeve.

Në vijim të shërbimeve ligjore në zyrë, TLAS ka organizuar aktivitete të "Street Law" për shpërndarjen e botimeve, për publikimin e informacioneve të thjeshta ligjore e komunikimin direkt me përfituesit. Objekti kryesor i aktiviteteve të Street Law ka qenë "Informimi mbi të drejtat civile". Gjatë vitit 2008, grupet e *street law* të TLAS kanë realizuar 48 aktivitete si vizita dhe takime të planifikuara, në Rrethin e Tiranës, në Fushë-Krujë, në Durrës, në Fier, Shkodër dhe Elbasan.

TLAS në vazhdimësi, bazuar në ekspertizën 10 vjecare, do të angazhohet gjatë viteve në vazhdim për fazën përgatitore të zbatimit të Ligjit "Për Ndihmën Juridike", bazuar në një Strategji të veçantë për të garantuar: (i) buxhetin dhe burimet e nevojshme që do t'i jepen ofruesve të shërbimeve ligjore falas të cilët do të asistojnë individët dhe grupet në nevojë (ii) respektimin e detyrimeve ndërkom-

bëtare nga shteti për sigurimin e aksesit në drejtësi për të gjithë, (iii) forcimin e sistemit gjyqësor përmes sistemit të ndihmës ligjore për mbrojtjen e të drejtave themelore, (iv) përmirësimin e sistemit demokratik të qeverisjes dhe shoqërisë.

Me mbylljen e vitit 2008, bazuar në analizat periodike, në bazën e të dhënave të TLAS si dhe në vëzhgimet me grupet e synuara të TLAS përsëri u konkludua të përzgjidhen këto objektiva strategjikë:

- 1) Shërbimi ndaj klientëve;
- 2) Ndërgjegjësimi i komunitetit për rritjen e aksesit të tyre në drejtësi;
- 3) Nisma për përmirësimin e legjislacionit dhe politikave sociale;
- 4) Përsosja e punës koordinuese dhe administruese;
- 5) Planifikim më të mirë në fushën e ngritjes së fondeve;

Elton Lula
Manaxher Programi
TLAS

Rëndësia e deklaratës së rrjetit të OJF-ve për Mbrojtjen e të Drejtave të Pakicave

Në kuadrin e 10 vjetorit të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKMPK), një grup OJF, që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve dhe të të drejtave të Romëve hartuan dhe shpallën





një deklaratë të përbashkët, që hodhi bazat e një aksioni afatgjatë, për të monitoruar zbatimin e mëtejshëm të Konventës nëpërmjet një rrjeti aktiv shoqatash. Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) ishte një ndër OJF pjesëmarrëse dhe nënshkruese të deklaratës.

Sipas deklaratës, KKMPK ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm për ngritjen dhe zgjidhjen e problemeve të pakicave dhe është shndërruar në një pikë të rëndësishme referimi për diskutimin e këtyre të drejtave në

Evropë. Kjo Konventë konsiderohet si mjeti më i rëndësishëm në ndërgjegjësimin për standartet ndërkombëtare për mbrojtjen e pakicave, për ndryshimin e politikave dhe praktikave në shërbim të tyre.

Mbrojtja e pakicave është ndër vlerat bazë të sistemit të Këshillit të Evropës. Konventa Kuadër vendosi një listë standartesh detyruese ligjore në fushën e mbrojtjes së këtyre pakicave, veçanërisht të gjuhës, kulturës, fesë dhe identitetit të tyre.

KKMPK nuk jep përkufizimin e "pakicës kombëtare", kështu që anëtarët e këtyre pakicave nuk janë qartësisht të identifikueshëm. OJF nuk janë të të njëjtit mendim për çështjen e këtij përkufizimi. Ndërkohë që disa pakica do të përfitonin nga një përkufizim i qartë, ekziston edhe rreziku që një përkufizim i tillë të ishte përjashtues, duke kufizuar qëllimin e mbrojtjes së pakicave. Në deklaratën e OJF-ve u vu në dukje, që Konventa duhet të theksojë parimin që ekzistenca

e pakicave është çështje faktike dhe jo çështje ligjore. Duke u nisur nga ky këndvështrim, OJF mendojnë se Komiteti Këshillues duhet të nxjerrë një përfundim të qartë, se cilat janë grupet, që duhet të mbulohen nga monitorimi i tij dhe ta paraqisë këtë pikëpamje në Komitetin e Ministrave. Shtetet duhet ta shtrijnë zbatimin e Konventës në të gjithë grupet e pakicave që vetëidentifikohen si të tilla.

Zbatimi i Konventës Kuadër dhe pjesëmarrja e pakicave në këtë proces, ka qënë e ndryshme në shtete të ndryshme. Pengesa kryesore në zbatimin e Konventës ka qënë perceptimi i gabuar se Konventa është një deklaratë politike dhe jo një traktat mbi të drejtat e njeriut, detyrues nga ligji ndërkombëtar. Por nga ana tjetër, mund të thuhet se Konventa Kuadër ka mundësuar mbrojtjen dhe promovimin e identitetit etnik, duke përfshirë çështje të tilla si gjuha, kultura dhe arsimi. Ajo ka kontribuar në ngritjen e çështjes së mbrojtjes së pakicave në një nivel institu-

cional nga ana e shteteve, duke kontribuar edhe në vendosjen e dialogut midis organizatave të pakicave dhe niveleve të ndryshme qeveritare. Nga ana tjetër, kjo Konventë luan edhe një rol të rëndësishëm si një instrument kundër diskriminimit.

Deklarata e OJF-ve theksoi që për lehtësimin e zbatimit të suksesshëm të Konventës Kuadër, duhet të ngrihet një mekanizëm më i mirë konsultimi midis shteteve dhe OJF-ve. Një mekanizëm i tillë duhet të përfshijë, por pa u kufizuar vetëm në të, një komunikim



dypalësh, ndërmjet shoqërisë civile dhe shteteve, duke e shoqëruar këtë edhe me shkëmbimin dypalësh të përshtypjeve. Në fakt, në një numër shtetesh, Konventa Kuadër ka shërbyer si një mjet i suksesshëm për krijimin e strukturave të komunikimit midis qeverive, nga njëra anë dhe grupeve të pakicave dhe shoqërisë civile, nga ana tjetër. Por për fat të keq, kjo nuk është një praktikë e përhapur në të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.



Deklarata vuri në dukje, se monitorimi i zbatimit të Konventës është realizuar nëpërmjet një sërë praktikash të mira, por mbetet ende për t'u bërë një punë e madhe. Nevojitet ngritja e një sistemi më të mirë raportimi. Vërehet se në disa raste shtetet nuk respektojnë afatet, duke dobësuar kështu sistemin e monitorimit. Për këtë arsye, në deklaratën e OJF kërkohet vendosja e sanksioneve për këto shtete, nga ana e Komitetit të Ministrave. Edhe Komiteti Këshillues duhet të shqyrtojë gjendjen, dhe të kryejë edhe vizita nëpër këto shtete, duke bërë publike praktikën e monitorimit, për pakicat dhe shoqërinë civile. Gjithashtu, në hartimin e raporteve nga ana e shteteve, duhet të përfshihen edhe pakicat, nëpërmjet një procesi konsultimi. Ndërkohë shoqëria civile mund të paraqisë raportet e saj alternative. Duke qënë të ndërgjegjshëm për mungesën e mjeteve të nevojshme financiare dhe burimeve të mjaftueshme njerëzore të shoqërisë civile, deklarata e OJF-ve thek-

son nevojën e ngritjes së një rrjeti organizatash në rang kombëtar dhe në kuadrin e Këshillit të Evropës, për të krijuar mbështetjen e nevojshme për këtë problem. Përfshirja efektive e shoqërisë civile dhe organizatave të të drejtave të pakicave në promovimin dhe zbatimin e Konventës Kuadër pengohet shpesh nga mungesa e fondeve për këtë lloj aktiviteti. Për këtë arsye, në Deklaratë ngrihet nevoja e krijimit të një Fondi për Shoqërinë Civile, që punon në fushën e të Drejtave të Njeriut.

Në zbatimin e Konventës Kuadër ka ndihmuar mjaft edhe krijimi i Komitetit Këshillues. Mendimet e këtij Komiteti i kanë dhënë pakicave rekomandime, standarte dhe argumenta për advokimin në nivel kombëtar. Deklarata ngre nevojën e përkthimit të materialeve të Komitetit Këshillues, të Komenteve të Shteteve, të Rezolutave të Komitetit të Ministrave në gjuhët kombëtare dhe në gjuhët e pakicave, për t'u mundësuar kryesisht pakicave të përfshihen në procesin e



monitorimit, pa e lënë këtë proces vetëm në duart e burokracisë, elitave, OJF-ve të specializuara, të cilat drejtohen kryesisht nga persona me prejardhje nga maxhoranca e popullsisë.

Nga ana tjetër, Deklarata ngre problemin e shkurtimit të kohës së shkruarjes së përfundimeve nga ana e Komitetit Këshillues, si dhe të përfshirjes edhe të pakicat dhe OJF-të që punojnë në këtë fushë për shkruarjen e tyre. Komiteti Këshillues duhet të vendosë lidhje të ngushta me OJF-të kombëtare dhe ato të pakicave, duke caktuar një per-



son kontakti që do të organizojë takimet, të paktën një herë në vit. Nga ky komitet, si edhe nga Komiteti i Ministrave kërkohet që të jenë më të hapur në punën e tyre, sidomos për diskutimet me shtetet. OJF duhet të kenë akses në këto diskutime dhe të lejohen të marrin pjesë në to.

Deklarata theksoi nevojën e përcaktimit të rrugëve për një zbatim sa më të suksesshëm të KKMPK. Ndërtimi i një mekanizmi për ankimim individual u konsiderua si hap shumë i rëndësishëm në këtë drejtim.

Në Deklaratë jepen një sërë rekomandimesh për Komitetin e Ministrave, Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Sekretariatit e KKMPK, Komitetin Këshillues, Shtetet, Shoqërinë Civile, Institucionet e Bashkimit Evropian dhe organizmat e tjera të Këshillit të Evropës dhe të Kombeve të Bashkuara.

Elvira Dervishi
Keshilltare Programi
TLAS

Histori e vërtetë

B.R. ka bashkëjetuar me A.K. dhe nga bashkëjetesa ata kanë një vajzë të vogël, të cilën e kanë regjistruar në fletën familjare të të jatit, A.K. B. së bashku me vajzën e saj jeton në Bregun e Lumit, pranë Kinostudios, në një barakë të ndërtuar me llamarinë dhe kartona. Në barakën e saj nuk janë as kushtet më minimale të jetesës. Nuk ka energji elektrike, as ujë, as kanalizime të ujrave të zeza.

Prej disa muajsh A.K. është dënuar me burgim, për një vepër penale dhe po e vuan dënimin në një burg në Tiranë. B. dëshëron të shkojë ta takojë personin me të cilin ajo po ndan jetën e saj, por ajo nuk pranohet në takime, meqë nuk figuron si bashkëshorte ligjërisht. Përveç këtij fakti, të dy dëshërojnë të bëjnë martesën ligjore dhe të krijojnë familjen e tyre, jo vetëm faktikisht, por edhe ligjërisht.



B. kërkoi ndihmën e TLAS, për të realizuar lidhjen e martesës. Nga ana jonë e sqaruam për procedurat e martesës, në bazë të Kodit të Familjes. Fillimisht, duhet të bëhej shpallja e martesës dhe më tej lidhja e martesës.

Për shpalljen e martesës nevojiteshin certifikatat personale të B. dhe A. me fotografi, për shpallje martese. Në zyrën e gjendjes civile ku A. është i regjistruar, nuk jepnin certifikatë me fotografi, pa praninë e tij. TLAS u angazhua për ta marrë këtë certifikatë. Mbas shumë përpjekjesh dhe takimit me drejtoreshën e burgut, morëm një vërtetim për

vendndodhjen e A.K. dhe për kohëzgjatjen e dënimit. Me këtë vërtetim u bë e mundur marrja e certifikatës me fotografi të tij. Mbas dorëzimit të certifikatës së B. në zyrën e gjendjes civile të A. dhe dorëzimit të certifikatës së A., në zyrën e gjendjes civile të B. u konsiderua e filluar procedura e shpalljes së martesës. Mbas 10 ditëve kjo procedurë mbaroi.

Për të realizuar lidhjen e martesës TLAS u interesua pranë drejtorisë së burgut, për të mundësuar shoqërimin e A.K. në zyrën e gjendjes civile, për të realizuar lidhjen e martesës me B.R. Drejtorja e burgut u tregua e gatshme të bashkëpunonte për të realizuar lidhjen e kësaj martese. Mbas shoqërimit të A.K. në zyrën e gjendjes civile, në prani të dëshmitarëve u realizua lidhja e martesës. B.R. realizoi përfundimisht dëshirën saj për të krijuar familjen e saj.



Elvira Dervishi
Keshilltare Programi
TLAS

Pavlefshmëria e aktit administrativ

Hyrje

Akti administrativ është shfaqje e vullnetit të organeve shtetërore për të krijuar, ndryshuar ose shuar pasoja të caktuara juridike dhe krahas elementëve të domosdoshëm që përcaktojnë përmbajtjen, formën kërkon ekzistencën e kushteve të tjera ligjore, mungesa e të cilëve sjell pavlefshmërinë e tij.

Pavlefshmëria është një gjendje juridike paligjshmërie që krijohet nga organi i administratës publike nëpërmjet zbatimit të gabuar ose vullnetit juridik të veësuar që shfaqet në aktin a vepërimit konkret administrativ.

Pavlefshmëria e aktit administrativ është e lidhur me paligjshmërinë, por nuk duhet asnjëherë të ngatërrohet me parregullsinë e aktit.

Kemi dy raste të pavlefshmërisë së aktit, pavlefshmëri absolute dhe relative.



Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm është akti që për shkak të shkeljes thelbësore të ligjit, nuk e ka fuqinë juridike të një akti të vlefshëm dhe objektivisht konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar për asnjë çast. Aktet administrative absolutisht të pavlefshme janë ato akte që nxirren në kundërshtim flagrant me ligjin. (neni 115 i K.Pr.A).

Rastet e pavlefshmërisë absolute (neni 116 i K.Pr.A):

1-Akti administrativ do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm



kur është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar dhe që nuk njihet si i tillë. Që një organ të konsiderohet i njohur nga ligji, ai duhet të jetë i pajisur me tagra pushteti, të jetë kompetent për veprimtarinë konkrete administrative që do të kryejë, si dhe të ketë strukturën përkatëse organizative administrative.

2- Akti administrativ nxirret nga një organ administrativ në kapërcim të kufijve të kompetencave të tij. Çdo organi administrativ i përcaktohet me ligj ose akt nën-

ligjor kompetenca për fushën që mbulon, me qëllim ushtrimin e të drejtave dhe detyrave brenda juridiksionit përkatës. Ushtrimi i kompetencave përtej kufijve të ligjit përbën cënimin e parimit të ligjshmërisë dhe për rrjedhojë, veprimet ose aktet administrative, që nxirren nga kjo veprimtari e pakufizuar dhe arbitrare sjellin domosdoshmërisht pavlefshmërinë juridike të tyre.

3- Kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji. Respektimi i formës dhe procedurës së nxjerrjes së aktit administrativ përbën një nga elementët më të rëndësishëm që përcakton vlefshmërinë e tij. Shkelja e formës dhe e procedurës, mund të paraqitet në mënyra të ndryshme, por e rëndësishme është të kuptohet që jo të gjitha shkeljet shpjen në pavlefshmërinë absolute të aktit, vetëm ato që janë bërë në mënyrë flagrante, çka do të thotë që mosrespektimi i elementëve duhet të jetë i asaj rëndësie, që të kenë ndikuar drejtëpërdrejt në nxjerrjen e aktit administrativ.

Efektet e aktit administrativ absolutisht të pavlefshëm

1. Aktet administrative absolutisht të pavlefshme nuk prodhojnë pasoja ligjore pavarësisht nga fakti nëse janë deklaruar apo jo si të tillë.

2. Secila palë e interesuar mund të kërkojë që akti administrativ të shpallet absolutisht i pavlefshëm. Kërkesa në fjalë mund të bëhet në çdo kohë. Organi administrativ kompetent, me nismën e tij mundet të deklarojë një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm në çdo kohë.

3. Në qoftë se vetëm një pjesë e aktit është absolutisht e pavlefshme, i gjithë akti do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm, në rast se pjesa që anulohet është aq e rëndësishme saqë pa të akti nuk e realizon qëllimin e tij.

Rastet e pavlefshmërisë relative:

1. Aktet administrative do të quhen relativisht të pavlefshme, kur ato janë nxjerrë në kundërshtim



tim me ligjin, por megjithatë nuk janë absolutisht të pavlefshme.

Kur përmbajtja e aktit nuk përputhet me përmbajtjen e ligjit

Rasti kur një subjekti të caktuar i njihen të drejtat, të cilat ligji nuk i parashikon ose kur akti i refuzon të drejtat dhe favore të cilin ligji ia njeh.

Kur përmbajtja e aktit nuk përputhet me qëllimin e ligjit

Autoriteti kompetent kur miraton një akt administrativ, ka një qëllim, i cili duhet të gjejë shprehjen në vullnetin juridik të shpre-

hur. Gjithashtu, vetë akti ka një qëllim i cili duhet të jetë në përputhje me qëllim që ka ligji. Kur përmbajtja e aktit gjatë zbatimit të tij rezulton se nuk i përgjigjet qëllimit të ligjit, jemi në kushtet e një pavlefshmërie relative. Pra sipas saj organi administrativ, nxjerr një akt duke iu referuar saktësisht si kompetencës ashtu edhe procedurës konkrete, por nuk kërkon krijimin e atyre pasojave që ka si qëllim ligj. Në një rast të tillë ai ndjek qëllime të tjera duke ushtruar pushtetin në mënyrë të shtrembëruar dhe të gabuar.

Kur vullneti i organit të administratës është me ves

Kur nxirret një akt ose kryhet një veprimi caktuar nga autoriteti shtetëror, duhet të ekzistojë një motiv a një dëshirë që materializohet në një vullnet juridik. Përputhja midis vullnetit të brëndshëm dhe deklarimit të jashtëm që organi shfaq me aktin ose veprimin administrativ përbën kusht për vlefshmërinë e aktit. Shkak i mospërputhjes mund të bëhen veset e vullnetit, gabimi ose lajthitja, mashtrimi, dhuna fizike morale etj.

Efektet e aktit administrativ relativisht të pavlefshëm

Për sa kohë që akti administrativ relativisht i pavlefshëm nuk është bërë objekt i ankimit administrativ ose gjyqësor brenda afateve të përcaktuara nga ky Kod, ose nuk është revokuar/shfuqizuar nga organi administrativ kompetent, ai prodhon efektet e një akti administrativ të vlefshëm/ të rregullt.



Kundërshtimi i pavlefshmërisë së aktit administrativ

Arsyet se përse pavlefshmëria e akteve dhe e veprimeve juridike duhet të kundërshtohet në procedurat e rishikimit administrativ dhe gjyqësore janë si më poshtë

1. Një akt administrativ megjithëse është i pavlefshëm, prodhon efekte juridike. Akti i pavlefshëm prodhon pasoja juridike të paligjshme deri në momentin që organi kompetent shprehet për të.

2. Kundërshtimet e paligjshme për të kryer një veprim të lejuar nga ligji, sjellin efekte tek subjektet deri në momentin që këto kundërshtime mënjanojnë nga organi kompetent që shqyrton çështjen.

3. Pamundësia e autoritetit për të riparuar vetë gjendjen e paligjshmërisë. Ka raste që autoriteti publik pranon se ka vepruar në mënyrë të paligjshme dhe ai ka pamundësi ligjore që të revokojë vendimin e vet. Ky rregull vlen për aktet e pavlefshme që nxirren nga organe



inkompetente, si dhe për ato raste që ligji nuk lejon organin ta revokojë atë.

Ankimi administrativ dhe rishikimi gjyqësor janë mundësitë që ligji iu njeh çdo individit ndaj arbitraritetit që mund të paraqesë një akt administrativ, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut të njohura nga kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Naureda Llagami
Avokate
TLAS

Histori e vërtetë

Pranë Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS) janë paraqitur klientët H.H dhe C.Ç të cilët kanë qenë punëtorë të fabrikës së çmontimit të municioneve në Gërdec dhe kanë qenë të punësuar rregullisht në këtë fabrikë. Është fakt i njohur botërisht se, për shkak se fabrika nuk ka respektuar legjislacionin shqiptar për marrëdhëniet e punës, klientët H.H dhe C.Ç nuk kanë lidhur një kontratë të shkruar pune për të provuar këtë fakt. Në bazë të një Akti Administrativ të Këshillit të Ministrave (Vendim)



Nr. 348, datë 01.04.2008 është vendosur dhënia e një ndihme të menjëhershme financiare punëtorëve të fabrikës së çmontimit të municioneve në Gërdec.

Këtë ndihmë financiare e kanë përfituar të gjithë punonjësit që kanë qenë të punësuar në fabrikë në ditën e ngjarjes së eksplozionit përveç dy klientëve H.H dhe C.Ç të cilët janë lënë jashtë listës së përfituesve.

Në bazë të vendimit të cituar më sipër kjo ndihmë financiare do të jepet në bazë të listës së punëtorëve të paraqitur nga personeli drejtues i fabrikës. Lënia e klientëve jashtë listës është rrjedhojë e procedurës së paplotë në evidentimin e personave të cilët kanë qenë të punësuar në fabrikë në ditën e eksplozionit. Konkretisht, përpilimi i listës, në mungesë të një dokumentacioni të plotë të punëdhënësit, fakt ky i njohur botërisht, i janë deleguar verifikimit nga ana e Bashkisë Vorë, e cila nga ana e saj ka besuar informacionin e servirur nga brigadieri përkatës i punëtorëve të fabrikës. Si pasojë e veprimeve

të pakujdesshme të brigadierit të punëtorëve pranë fabrikës, i cili ka deklaruar 158 punëtorë, ndërkohë që realisht atje ndodheshin 160 punëtorë, pra edhe dy klientët e mësipërm. Në këto kushte këta të fundit nuk kanë mundur të bëhen pjesë e listës bashkalidhur Vendimit të KM. Ky fakt provohet edhe nga deklarata noteriale e lëshuar nga Z. V. M.

Avokati i TLAS-it fillimisht nisi procedurat administrative duke i kërkuar organit që ka nxjerrë aktin administrativ (Vendimin), Këshilli i Ministrave ndryshimin/korrigjimin e aktit administrativ (vendimit nr 348 datë 1.4.2008). Por nga ana e organit administrativ kompetente u mor një përgjigje negative për kërkesat e paraqitura.

Në rrethanat e mësipërme, e vetmja rrugë e mundshme për ndryshimin/korrigjimin e akti administrativ objekt kundërshtimi, është ajo gjyqësore.

Naureda Llagami
Avokate
TLAS

KUSHTET PËR LIDHJEN E MARTESES, NDALIMET DHE RASTET E PAVLEF- SHMËRISË SË SAJ

Një ndër proceset më të rëndësishme që është shumë i përhapur në shoqëri është edhe instituti i martesës.

Vetë ligjvënësi këtij instituti i ka dhënë një rëndësi të madhe duke parashikuar edhe disa kushte dhe kritere të tjera të detyrueshme.





Pra që një martesë të jetë e vlefshme dhe të lidhet në plotësim të përcaktimeve të vëna nga ligji duhet të plotësojë disa kushte:

Sipas Kodit të Familjes, martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Gjykata e vendit ku lidhet martesa, për shkaqe me rëndësi, mund të lejojë martesën edhe përpara kësaj moshe. Martesa lidhet para nëpunësit të gjendjes civile, me pëlqimin e lirë të dy

bashkëshortëve të ardhshëm.

Gjithashtu ligjvënësi ka parashikuar edhe disa raste në të cilat martesa nuk mund të lidhet, kështu nuk mund të lidhë martesë të re personi që është martuar, derisa martesa e mëparshme nuk është shpallur e pavlefshme ose nuk është zgjidhur. Nuk mund të lidhin martesë midis tyre të paralindurit dhe të paslindurit, vëllai dhe motra, ungjii dhe mbesa, emta dhe nipi, si dhe fëmijët e vëllezërve dhe të motrave.

Gjykata, për shkaqe me rëndësi, mund të lejojë martesën midis fëmijëve të vëllezërve dhe të motrave. Përsa i përket paragrafit të fundit shkaqe me rëndësi do të shqyrtohen rast pas rasti nga gjykata dhe do të vlerësohen nëse janë të vlefshme apo jo.

Nuk mund të lidhë martesë personi që vuan nga një sëmundje e rëndë psikike ose ka zhvillim mendor të metë, që e bën të pa aftë të kuptojë qëllimin e martesës. Ndalohet martesa midis kujdestarit dhe personit që ndodhet në kujdesin e tij gjatë

kohës që vazhdon kujdestaria, ndalohet martesë midis birësuesit e të birësuarit dhe pasardhësve të tyre. Nëse martesë lidhet në kundërshtim me ndonjë nga rastet e sipërpërmendura ajo shpallet automatikisht e pavlefshme.

Një martesë do të konsiderohet e pavlefshme:

- kur ajo është lidhur pa pëlqimin e lirë dhe pa vese të të dy bashkëshortëve ose të njërit prej tyre. Martesë e lidhur në lajthim për personin e bashkëshortit shpallet e pavlefshme;

- ka lajthim për personin, kur njëri nga bashkëshortët lidh martesë me një person që nuk është ai me të cilin dëshiron të martohet;

- martesë e lidhur nga një person që vuan nga një sëmundje e rëndë psikike ose ka zhvillim mendor të metë, që e bën të pa aftë të kuptojë qëllimin e martesës.

- martesë e lidhur nga bashkëshortët pa pasur qëllim për jetë të përbashkët si burrë e grua.

- martesë e lidhur në kushtet kur njëri nga bashkëshortët gjendet nën ndikimin e një kanosjeje, pa të cilën nuk do të lidhej martesë, shpallet e pavlefshme.

Martesë e lidhur nga personi që nuk ka mbushur moshën është e pavlefshme. Një martesë e tillë nuk shpallet e pavlefshme kur personi ka arritur moshën e kërkuar, ose kur gruaja ka lindur fëmijë ose ka mbetur shtatzënë. Martesë e lidhur gjatë vazhdimit të një martese të mëparshme të





njërit prej bashkëshortëve është e pavlefshme. Kur gjatë gjykimit për pavlefshmërinë e martesës, bashkëshortët pretendojnë se martesa e mëparshme ka qenë e pavlefshme ose e zgjidhur, gjykohej më parë vlefshmëria ose ekzistenca e martesës së mëparshme dhe, në qoftë se kjo martesë shpallet e pavlefshme, martesa e dytë mbetet e vlefshme.

Martesa që nuk është lidhur publikisht dhe përpara nëpunësit të gjëndjes civile është e pavlefshme.

Të drejtën e padisë për pavlefshmërinë e martesës së lidhur pa pëlqimin e lirë të dy bashkëshortëve ose të njërit prej tyre e kanë të dy bashkëshortët ose bashkëshorti, pëlqimi i të cilit nuk ka qenë i lirë. Të drejtën e padisë për pavlefshmërinë e martesës së lidhur me kanosje ose me lajthim e ka vetëm bashkëshorti që ka qenë i kanosur ose në lajthim.

Kur bashkëshortit i është hequr zotësia për të vepruar, padia për pavlefshmërinë e martesës mund të ngrihet nga kujdestari i tij.

E drejta e padisë për shpalljen e pavlefshmërisë së martesës nuk u kalon trashëgimtarëve, përveçse kur gjykimi ka filluar përpara vdekjes së bashkëshortit.

E drejta e trashëgimtarëve kufizohet vetëm për rastet që prekin rendin publik dhe jo për raste që kanë të bëjnë thjesht me mbrojtjen e të drejtave të bashkëshortëve.

Martesa që shpallet e pavlefshme më vendim të formës së

prerë konsiderohet se nuk është lidhur. Për bashkëshortin që nuk ka ditur shkakun e pavlefshmërisë së martesës, pasojat fillojnë nga data që vendimi merr formë të prerë.

Fëmijët e lindur nga një martesë që shpallet e pavlefshme, quhen si të lindur nga martesa dhe marrëdhëniet midis tyre dhe prindërve rregullohen si në rastet kur zgjidhet martesa.

Vëmë re se paragrafi i fundit është mjaft i rëndësishëm, pasi tregon për rëndësinë e madhe që ligjvënësi i ka dhënë mirëqënies së fëmijës.

Këto ishin disa nga rastet tipike të ndalimit dhe pavlefshmërisë së martesës.

Adrian Shega
Avokat, Këshilltar Paraligjor
TLAS

Histori e vërtetë

Pranë Zyrës tonë u paraqit një klient i cili jetonte në qytetin e Tiranës me initiale V.N. Pasi kishte marrë vesh për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet personave të tjerë, ai u paraqit duke kërkuar mbrojtje ligjore për të drejtat e të tij që i ishin shkelur nga bashkëshortja e tij gjatë kohës që ata kishin qenë të martuar.

Pasi u krye një intervistë me të u identifikuan problemet e tij. Nga intervista u konstatua se klienti



V.N për një periudhë të gjatë kohe kishte jetuar në shtetin Grek. Në vitin 2007 bashkë me bashkëshorten e tij kishin blerë një pasuri të paluajtshme konkretisht një banesë. Në atë kohë për të shmangur harxhimet ishte kthyer nga Greqia për të firmosur kontratën e shtëpisë vetëm bashkëshortja e tij M.N, e cila ka firmosur edhe kontratën e shitblerjes së apartamentit për shkak se klienti V.N nuk mund të udhëtonte drejt Shqipërisë, pasi nuk ishte i pajisur me dokumentacion të rregullt nga shteti Grek. Këtë kontratë bashkëshortja e tij M.N e ka paraqitur pranë Zyrës

së Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, ku ka bërë edhe regjistrimin e saj. Në momentin që është regjistruar kjo pasuri është regjistruar vetëm në emrin e bashkëshortes duke u nisur nga fakti se ajo ishte i vetmi person i cili kishte firmosur kontratën e shitblerjes.

U paraqit çështja në mbledhjen e radhës së Zyrës dhe nga diskutimet u arrit në përfundimin se kjo çështje mund të ndiqej nga avokatet e zyrës tonë por vetëm përsa i përket përpilimit të dokumentave të nevojshëm për gjyq dhe të gjithë dokumentave të tjerë që do të kërkoreshin nga gjykata gjatë zhvillimit të procesit.

U shqyrtua rasti dhe u mendua që të përpilohej një padi me objekt "njohjen e klientit V.N si bashkëpronar të banesës".

Neni 32 i K.Pr.Civile shprehet se "padia mund të ngrihet për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur".

Në rastin e klientit V.N ishte shkelur në mënyrë flagrante e drejta



e tij e bashkëpronësisë mbi këtë pasuri pasi bashkëshortja e tij në mënyrë të paligjshme dhe me veprime anti ligjore ka arritur ta regjistrojë këtë pasuri vetëm në emrin e saj.

Sipas nenit 73 të Kodit të Familjes “Regjimi pasuror martesori i bashkësisë ligjore zbatohet kur bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë për regjim tjetër pasuror martesori”. Pra cdo pasuri e fituar gjatë martesës është në bashkëpronësi të dy bashkëshortëve. Sipas certifikatës së martesës paditësi dhe e Paditura kishin lidhur martesë në vitin 1980 ndërsa kontrata e shitblerjes së apartamentit është lidhur në vitin 1997, pavarësisht se kontrata është firmosur vetëm nga bashkëshortja, ky nuk është shkak ligjor që ajo të jetë pronare e vetme e apartamentit pasi cdo gjë e fituar gjatë martesës i nënshtrohet regjimit pasuror të bashkësisë ligjore, pra është në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve. U depozitua kërkesë-padia në gjykatë dhe u procedua me hapat e mëtejshëm, ku u zhvilluan disa seanca gjyqësore, gjatë



kësaj kohe vazhdimisht çështja u ndoq nga avokati i caktuar duke përgatitur dokumentacionin ligjor në lidhje me çështjen. Gjykatë arriti në përfundimin se klienti V.N kishte të drejtë në kërkimin e tij duke i njohur në këtë mënyrë të drejtën e bashkëpronësisë mbi banesën.

Mbas një pune të gjatë duke vlerësuar dhe kontributin e madh të Zyrës për Shërbimin Ligjor Falas u arrit në përfundimin e dëshiruar nga klienti V.N.

Adrian Shega
Avokat, Këshilltar Paraligjor
TLAS

PROÇESI I RREGULLT LIGJOR

Një nga sfidat me të cilat po përballët sot Shqipëria është anëtarësimi në strukturat Euro-atlantike, NATO dhe Bashkimi European. Ky anëtarësim kërkon kryerjen e një sërë reformash jo vetëm institucionale, por edhe ekonomike e sociale. Jo rrallë herë, historia e integritimit ka treguar se si vendet që aspirojnë të jenë anëtare të kë-

tyre strukturave, i nënshtrohen transformimeve të brendshme si kusht për të hyrë në familjen e madhe Europiane.

Në Samitin e Kopenhagenit të vitit 1993 u përcaktuan për herë të parë kriteret që duhet të plotësojë një vend për të qënë kandidat për shtet anëtar në Bashkimin European, të ashtëquajtura kriteret e Kopenhagenit. Keto kritere janë:

- Kriteri politik
- Kriteri ekonomik
- Aftësia për të marrë përsipër detyrime

Kriteri politik do të thotë se shteti që aspiron për t'u futur në BE është një shtet i së drejtës, ku veprojnë ligje demokratike dhe respektohen të drejtat themelore të njeriut. Barazia e të gjithëve para ligjit, të drejtat e njeriut dhe mosdiskriminimi i minoriteteve janë vlera që duhet të përthithen nga shtetet anëtare.

Kriteri ekonomik nënkupton që brenda këtij shteti duhet të



funksionojë ekonomia e tregut, konkurrenca dhe të luftohen praktika të padrejta si imitimet, monopolet etj. Çdo shtet kandidat duhet të forcojë ekonomine e tij, të fusë teknologji të avancuar të rrisë cilësinë e shërbimit dhe standartet e produkteve që keto mund të përballojnë konkurrencën e një tregu të fuqishëm si ai i BE.

Aftësia për të marrë përsipër detyrimet ka të bëjë me aftësinë e shtetit për të bërë pjesë e legjislacionit të tij ligjet komunitare të quajtura acqis communittair dhe për të qënë në një linjë me detyrimet që kanë shtetet e tjera anëtare të BE se brendshmi dhe në arenen ndërkombëtare.

Shqipëria si shtet që aspiron të jetë pjesë e BE në një të ardhme të afërt, duhet të paraqesë një histori suksesi në përmbushjen e këtyre kriterëve.

Mbajtja e zgjedhjeve ne Qershorin e ketij viti është krye-testi që Europa ka vënë për integrimin, por nuk është test i vetëm. Një

nga pikat e tjera të rëndësishme lidhur me kriterin politik është respektimi i të Drejtave themelore të Njeriut, referenca për të cilat i gjejmë në akte të ndryshme ndërkombëtare, ku më kryesori është Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Është i padiskutueshëm roli që zënë sot të drejtat themelore të njeriut në sistemin e qeverisjes demokratike. Ato janë letra e lakmuesit që përcakton nëse një system është autoritar apo demokratik, demokraci e kon-





soliduar apo ne tranzicion. Të drejtat themelore të njeriut si e drejta e jetës, liria e shprehjes, liria e jetës private, e drejta për një jetë familjare, procesi i rregullt ligjor, e drejta për një pronë private etj, janë bazat mbi të cilat ngrihet qeverisja modene, e jo vetëm kaq, janë detyrime që çdo shtet demokratik i ka jo vetëm ndaj qytetarëve të tij, por edhe detyrime te cilat ai është angazhuar t'i përmbushë në arenën ndërkombëtare.

Ku po çalon Shqipëria në këtë drejtim? Nëse do t'i hidhnim një sy vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, numri më i madh i çështjeve kundër Shqipërisë ka të bëjë me mosrespektimin e se drejtes për një proces të rregullt ligjor (neni 6 i Konventës), e drejtë e cila garantohet edhe nga Kushtetuta në Nenin 42 të saj.

Garantimi thjesht me ligj i të drejtave themelore të njeriut nuk është i mjaftueshëm për të qënë një shtet demokratik, pasi garantimi i një të drejte në letër pa patur mekanizmat dhe forcën e zbatimit, do të ishte si një e shkruar mbi rrëzë.

Të drejtat themelore të njeriut të garantuara nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut kanë jo vetëm aspektin negativ, që nënkupton detyrimin e shtetit për mos t'i shkelur keto të drejta, por edhe aspektin pozitiv, detyrimin e shtetit për të marrë të gjitha masat për zbatimin e tyre.

Njohja e elementeve të së drejtës për një proces të rregullt ligjor është së pari detyrim i të gjithë aktorëve të administratës publike dhe gjyqësore, por nga ana tjetër edhe i qytetarëve për t'i bërë këta të ndërgjegjshëm për mënyrat dhe caqet brenda të cilës ushtrohet kjo e drejtë, për mosrespektimin e së cilës ata mund t'i drejtohen autoriteteve përkatëse.

Neni 6 i KEDNJ:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të ndonjë akuze penale kundër tij, çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar sipas ligjit. Vendimi shpallet publikisht, por prania në sallën e gjyqit për përfaqësuesit e shtypit dhe për publikun mund të ndalohet kur një gjë të tillë e kërkon interesi i ruajtjes së moralit, rendit publik ose sigurimit kombëtar në një shoqëri demokratike, kur e kërkojnë interesat e të miturve,



mbrojtja e jetës private të palëve në gjykim, tërësisht ose në atë masë që gjykata e mendon rreptësisht të nevojshme në rrethana të veçanta kur publiciteti do të paragjykonte interesat e drejtësisë.

2. çdo njeri që akuzohet për vepër penale prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet në përputhje me ligjin.

3. çdo njeri që akuzohet për vepër penale ka këto të drejta minimale:

a. të vihet në dijeni brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe me hollësi për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij;

b. të ketë kohën e lehtësitë e përshtatshme për të përgatitur mbrojtjen e tij;

c. të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës ligjore që e zgjedh vetë dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme që të paguajë për ndihmë ligjore, kjo t'i jepet pa pagesë kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d. të pyesë vetë ose të kërkojë të pyeten dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë thirrjen dhe pyetjen e dëshmitarëve në favor të tij në të njëjtat kushte si dëshmitarët kundër tij;

e. të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi gojor nëse ai nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret në gjykatë".

Siç mund të kuptohet nga një lexim i thjeshtë i Nenit 6, ky nen garanton të drejtën për një proces të rregullt ligjor, si në fushën penale edhe atë civile. Sa më poshtë do të merret në analizë vetëm aspekti civil i këtij neni dhe konkretisht elementët "proces i drejtë", "publiciteti i seances", "kohë e arsyeshme", "gjykatë e pavarur dhe e paanshme".

Proçes i drejtë. Neni 6 deklaron se çdokush ka të drejtën e një procesi të drejtë gjyqësor. Kjo shprehje mbart në vetvete disa elementë, si e drejta për akses në gjykatë, barazia në mjete dhe një gjykim i arsyeshëm. Aksesit në gjykatë do të thotë



mundësia reale dhe efektive e qytetarëve për t'ju drejtuar gjykatës për zgjidhjen e konflikteve të tyre.

Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e vet dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë ndonjë avantazh të konsiderueshëm ndaj kundërshtarit. Duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë midis palëve. E drejta për një proces të rregullt përfshin gjithashtu edhe nocionin se të dy palët në një proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet dhe argumentet e palës kundërshtare, që nënkupton në parim mundësinë për palët në një seancë civile apo penale që të kenë njohuri edhe mbi komentet mbi provat e nxjerra ose hetimet e arkivuara

Detyrimi i arsyeshmerise së vendimit nga Gjykata është një detyrim i vendosur jo vetëm nga Konventa, por edhe Kushtetuta. Detyrimi për arsyetimin e vendimit nuk do të thotë se Gjykatat janë të detyruara të japin



përgjigje të detajuara për çdo pyetje, por që nëse një kërkesë është thelbësore për rezultatet e çështjes, gjykata atëherë duhet që specifkisht t'a trajtojë atë në gjykimin e tij .

Në "*Hiro Balani kundër Spanjës*", kërkuesi kishte bërë një kërkesë në gjykatë që kërkonte një përgjigje specifike e të shpejtë. Gjykata nuk i dha dot përgjigjen duke krijuar dyshimin që ajo thjesht e kishte neglizhuar trajtimin e çështjes.

Publiciteti i seancës. Neni 6 lidhur me këtë pikë parashikon rregullin e përgjithshëm dhe përjashtimin. Si rregull seancat janë me dyer të hapura, lehtësisht të aksesueshme nga të gjithë. Megjithatë parashikohet se shtypi dhe publiku mund të përjashtohen nga i gjithë procesi gjyqësor ose një pjesë e tij kur kjo është:

1. në interes të moralit ose rendit publik

2. sigurimit kombëtar në një shoqëri demokratike



3. për të mbrojtur interesat e të miturve ose të jetës private të palëve,

ose 4. ku publiciteti do të parajgykonte interesat e drejtësisë. Një seancë e hapur përbën një tipar thelbësor të së drejtës për një proces të drejtë gjyqësor

Afati i arsyeshëm. Neni 6 i garanton çdokujt një seancë brenda një afati kohor të arsyeshëm. Ky parim shkon në të njëjtën linjë me parimin e vjetër romak "Drejtësi e vonuar, drejtësi e mohuar".

Kuptimi i kushtit të afatit kohor të arsyeshëm është bërë për të garantuar që brenda një afati kohor të arsyeshëm dhe me anë të një vendimi gjyqësor ti jepet fund pasigurisë që ka një person përsa i përket pozitës së tij. Kjo është në interes të personit në fjalë si dhe të sigurisë ligjore.

Koha që duhet marrë në konsideratë fillon me nisjen e procedimeve dhe përfundon kur procedimet janë konkluduar në shkallën më të lartë të mundshme të gjykatës, d.m.th. kur

vendimi bëhet i formës së prerë. Konventa nuk përcakton me terma konkret afatin e arsyeshem brenda të cilit duhet të shqyrtohet një çështje, as nuk vendos ndonjë afat maksimal për afatet në procesin civil, por ja lë këtë në vlerësim gjykatës rast pas rasti.

Megjithatë Gjykata Europiane e Drejtësisë në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa elementë për të konsideruar çfarë do të quhet kohë e arsyeshme. Faktorët që merren në analizë rast pas rasti janë: kompleksiteti i çështjes, sjellja e kërkuarit, sjellja e autoriteteve gjyqësore dhe administrative të Shtetit. Kuptohet që sa më e komplikuar të jetë një çështje aq më e gjatë do të jetë koha e procedimit gjyqësor të saj, derisa gjykata të dalë me një vendim të formës së prerë. Nga ana tjetër sjellja e kërkuarit mund të zvarrisë procesin dhe në këtë rast gjykata shkarkohet nga përgjegjësia për shkelje të Nenit 6. Në të kundërt, kur autoritet me veprimet dhe mosveprimet e tyre vonojnë procesin

dhe gezimin e të drejtave nga qytetarët, Shteti në fjalë do të konsiderohet shkelës i detyrimit të përcaktuar nga Konventa.

Gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Që të jemi në kushtet për një proces të rregullt ligjor, gjykata që shqyrton mosmarrëveshjen duhet të jetë e pavarur dhe e paanshme. Pavarësia e gjyqësorit ka të bëjë me pavarësinë e tij nga pushtetet e tjera, kryesisht ekzekutivi si dhe nga palët në proces. Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut në disa vendime të saj ka përcaktuar cilët



janë treguesit nëse një gjykatë është apo jo e varur:

1. mënyra e zgjedhjes dhe shkakimit të gjyqtarëve.

2. afati i caktimit të tyre në detyrë

3. ekzistencën e garancive kundrejt presioneve të jashtme.

Paanshmëria nënkupton mungesën e paragjyimeve ose anshmërisë. Tregues të paanshmërisë mund të jenë qendrimet subjektive, sjelljet e gjyqtarit. Nga gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, pjesëmarrja në gjykim në role të ndryshme,

psh njëherë si prokuror njëherë si gjyqtarë në të njëjtën çështje, konsiderohet si element njëanshmërie në gjykim.

Së fundi duhet thënë se është detyra e gjyqtarit gjatë një gjykimi që të sigurojë që të gjitha palët në një mosmarrëveshje të kenë një "proçes të drejtë gjyqësor", me të gjitha elementët e garantuar nga Konventa. Çdo qytetar të cilit i është shkëllur kjo e drejtë mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese dhe pasi ka ezauruar të gjithë mjetet e brendshme ti drejtohet Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për mbrojtjen e të drejtës së pretenduar.

Nga ana tjetër është detyrimi i shtetit tonë që të marrë të gjitha masat për të garantuar zbatimin efektiv të të drejtave të Njeriut të sanksionuara në Konventë. Suksesi i një shteti dhe shkalla e civilizimit demokratik varet pikërisht nga mënyra se si garantohen dhe zbatohen keto të drejta.



Fjoralba Caka
Ass. Avokate
TLAS

SI MUND TË ARRIHET SUKSESI I NJË ORGANIZATE JOFITIMPRURESE

Sipas legjislationit tonë është relativisht e lehtë të krijosh një organizatë jofitimprurëse, pasi përvec rregullave ligjore të cilat janë detyruesisht të zbatueshme, duke përfshirë regjistrimin në gjykatë, në organet tatimore etj, ligji nuk përcakton detyrime të rënda për t'u realizuar prej subjekteve dhe si rrjedhim sot në Shqipëri, në të gjithë vendin ekzistojnë dhe veprojnë një numër shumë i madh organizatash jofitimprurëse.

Megjithatë zbatimi i rregullimeve ligjore nuk është i vetmi element që bën një organizatë të suksesshme. Përvec dëshirës së personave për ta realizuar punën e tyre nëpërmjet një organizate, përcaktimit të punës që do të bëjnë dhe subjekteve të cilëve do t'u drejtohen, përvoja ka treguar se është e nevojshme edhe një mirëorganizim i funksioneve të vetë organizatës.



Sot, gjithmonë e më tepër po zhvillohen teori lidhur me arritjen e suksesit së një organizate dhe po zhvillohen edhe shkencatë vecanta, që trajtojnë këto elemente. Një shkencë tepër efikase dhe e studiuar gjerësisht është planifikimi strategjik, si një *“përpjekje e disiplinuar për të prodhuar vendime dhe veprime themelore të cilat i japin formë dhe përcaktojnë se çfarë është një organizatë, çfarë bën ajo dhe pse”*



Çdo organizatë në fillimet e veta dhe në periudha vështirësie duhet të marrë përsipër zgjidhjen e shumë çështjeve. Ky proces është i vazhdueshëm dhe nuk ka përfundim, por ai evoluon, ai duhet rishikuar dhe adaptuar vazhdimisht dhe kërkon mjaft përpjekje. Hapi i parë do të ishte formulimi i misionit të organizatës. Përpara se të realizohet ky hap organizata duhet të përcaktojë vizionin, vlerat dhe filozofinë e saj, të cilat duhet të përputhen me strategjinë e kësaj organizate, elemente të

cilët përcaktojnë sesi do të zgjidhë problemet organizata dhe si menaxhon klientët, aktivitetet etj. Vizioni në përgjithësi shprehet me një fjali të vetme dhe përmban një mendim apo një deklaram sesi perceptohet organizata prej anëtarëve të saj.

Më pas kalohet në hartimin e misionit të saj, që duhet t'u japë përgjigje disa pyetjeve si Cila është kjo organizatë? Pse organizata ekziston? Cfare funksionesh kryen? Kujt do t'i adresohen këto funksione? dhe Si do të realizohen këto funksione? Misioni përmban një deklaram se ku dëshiron të arrijë organizata. Pyetjes se pse organizata ekziston, përgjigja duhet t'i vijë kësaj pyetje jo vetëm duke dashur të shprehë arsyen e ekzistencës së saj, por të përfshijë në të njëjtën kohë, vlerat, filozofinë dhe kulturën e saj. Vlerat përcaktojnë sjelljen e organizatës, këto vlera apo besime të organizuara përbëjnë filozofinë e saj, që i jep shpjegim faktit se si vepron organizata dhe u jep zgjidhje problemeve.

Hap tjetër do të jetë evidentimi dhe analizimi i ndikimit të “të interesuarve”. Kjo është një fjalë e cila ka hyrë edhe në fjalorin e gjuhës shqipe dhe përdoret e tillë. Ajo ka kuptimin e individëve apo grupeve të individëve që ndikojnë apo ndikohen prej organizatës, duke përfshirë stafin, drejtuesit, organe këshillimore apo drejtuese, klienët, sindikatat, qeverinë apo organe administrative shtetërore, media, publiku etj. Qëllimi i një analize të “të interesuarve” është të nxjerrë në pah interesat dhe ndikimin e këtyre në organizatë. Hap i parë është njohja dhe identifikimi i tyre, të cilët mund të ndahen në të brendshëm dhe të jashtëm. Si të interesuar të brendshëm identifikohen stafi, anëtarët e organeve drejtuese, ndërsa si të jashtëm janë individë apo grupe të jashtëm që ndikohen prej veprimtarisë së organizatës psh klientët, institucione shtetërore dhe qeveritare, organizata partnere, komuniteti etj.

Hap i dytë është analizimi i interesave dhe ndikimeve të tyre

në shoqatë. Psh, një organ qeveritar kërkon të nxjerrë një ligj apo të marrë masa lidhur me përfituesit e organizatës, nevojat e klientëve diktojnë veprimtarinë e shoqatës.

Një hap tjetër do të jetë analizimi dhe vlerësimi i interesave dhe nevojave të organizatës ndaj “të interesuarve”. Ky hap duhet hedhur pasi veprimtaria e organizatës duhet të jetë në përputhje me interesat e “të interesuarve” dhe të analizohet mundësia e saj për t’ju përshtatur atyre.



Një fazë tjetër do të ishte përcaktimi i faktorëve të jashtëm, që ndikojnë në organizatë, parashikimi i tyre do të ishte shumë jetësor për sjelljen e organizatës, vendimet që ajo do të marrë dhe mbijetesën e saj. Këto forca apo faktorë janë ekonomikë (varfëria, inflacioni, taksa dhe tatime etj), politikë (ligje, politika qeveritarë, zgjedhjet etj), shoqërore (demografia, popullsia, emigracioni etj) teknologjike (interneti, pajisje etj).



Kjo analizë e faktorëve të jashtëm pasohet me analizën e faktorëve të brendshëm, me analizën e fuqive, dobësive, mundësive, kërcënimeve (SWOT). Fuqitë kanë të bëjnë me atë çka organizata ka si avantazh apo burime, dobësitë lidhen me mangësi, kufizime në burime, të cilat vijnë nga brenda mjedisit të organizatës. Mundësitë dhe kërcënimet lidhen më tepër me ndikimet e mjedisit të jashtëm në organizatë, që mund të jenë situata të favorshme apo të pafavorshme me të cilat përballen organizata. Rëndësia e kësaj analize qendron në evidentimin e këtyre faktorëve duke bërë një renditje të të gjithë faktorëve, që ndikojnë në OJF duke i përcaktuar ata sipas ndarjes SWOT.

E gjithë kjo analizë, që përfshin disa aspekte, elemente, jo vetëm që ka ndikim në aktivitetin e organizatës, në ekzistencën e vetë organizatës, por gjithashtu e ndihmon atë pasi është pjesë përbërëse e procesit të hartimit të strategjive të organizatës,

që shërbejnë për arritjen e qëllimeve të rëndësishme, që do të përcaktojnë vazhdimësinë dhe suksesin e saj.

Anisa Haxhiaj
Avokate/ këshilltare paraligjore
TLAS

Histori e vërtetë 1

Klienti S.L u paraqit pranë zyrës së Shërbimit Ligjor pasi ai ishte hasur me një problem të pazakontë lidhur me të dhënave e regjistrave të gjendjes civile. Klienti është i lindur më datë 28/02/1943 lindur dhe banues në një komunë të Tiranës. Në kohën e lindjes atij nuk i është mbajtur akti i lindjes prej zyrës së gjendjes civile pasi në kohën e lindjes





së tij ende nuk ishte konturuar sistemi i regjistrimit të shtetasve shqiptarë dhe të gjitha veprimet si lindjet, vdekjet e tyre etj realizoheshin sipas sistemit ottoman nëpërmjet një procesi gjyqësor dhe mbaheshin më pas në arkivat përkatëse.

Regjistrimi i parë i plotë i popullsisë shqiptare është realizuar në vitin 1945 dhe është ndjekur nga ai i vitit 1950 dhe i fundit më 1974, për të cilat vite janë mbajtur edhe regjistrat përkatëse me të dhënat e shtetasve shqiptarë. Klienti duke iu përgjigjur detyrimeve shtetërore si një individ i këtij shteti, bëri kërkesën për t'u

pajisur me kartë identiteti pranë zyrave të atashuara pranë Komunave të qytetit të Tiranës. Pas kontrollit që punonjësit e gjendjes civile realizuan doli se ditëlindja e klientit është e regjistruar në datë 30 shkurt dhe jo 28 sic duhet të ishte në të vërtetë. Ky fakt bëri që atij t'i mohohet mundësia për të aplikuar derisa kjo çështje të rregullohej.

Kienti u adresua pranë TLAS, ku avokati gjatë intervistës kërkoi që të pajisej me aktin e lindjes së klientit, që paraqet dokumentimin e parë të lindjes së individit. Sipas parashikimeve të ligjit dt.10.10.2002 "Për gjendjen civile" neni 35, akti i lindjes vërteton ligjërisht lindjen e shtetasit dhe mbahet në librin përkatës të zyrës së gjendjes civile të prindërve, kronologjikisht, sipas datës së deklarimit. Përgjigja prej arkivës së gjendjes civile pranë Bashkisë së Tiranës ishte negative duke shprehur se gjatë viteve 1943-1944 nuk janë mbajtur akt lindje dhe zyra përkatëse e gjendjes civile nuk i disponon këto akte.

Avokati këshilloi S.L që në të njëjtën kohë ai të kontrollonte dhe të pajisej me çertifikata personale të gjendjes civile sipas regjistrave të vitit 1945 dhe 1950. Klienti arriti të siguronte vetëm çertifikatë të gjendjes familjare dhe martese të regjistruara sipas këtyre regjistrave. Ky fakt vërteton se akti i tij lindjes nuk mund të sigurohej dhe ai përballet me një mungesë të saj, ndonëse të dhënat e tij personale si individ ekzistojnë. Kjo të çon në përfundimin se regjistrimi i tij i lindjes nuk është bërë bazuar në aktin e lindjes.

Në të njëjtën kohë problemi i të dhënave të regjistrit të gjendjes civile shfaqet edhe në datën e tij të lindjes e cila shënohet si datë lindje 30 shkurti.

Problemi i klientit haste dy momente vështirësie a) mungesa e aktit të lindjes b) dhe data e gabuar, por që mungesa e aktit të lindjes vështirëson korigjimin e kësaj date.

Gjithashtu, viti 1943 përmban muajin shkurt me 28 ditë dhe ky fakt tregon se është bërë një gabim në mbajtjen e të dhënave.

Çështja duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit ligjor, pasi gjykata është i vetmi organ, që mund t'i japë zgjidhje këtij problemi. Sipas nenit 388 të Kodit të Procedurës civile "nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që e vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër"

Nëpërmjet procedurës gjyqësore do të realizohen të dy këto



hapat, i pari është vërtetimi i faktit të lindjes, në mungesë të aktit të lindjes dhe korigjimi i datës së lindjes.

Ky proces do të çojë në një rregullim të kësaj situate dhe klienti do të ketë mundësinë të pajiset me kartën e identitetit pasi të bëhet më parë korigjimi i të dhënave të tij të gjendjes civile lidhur me datën e lindjes.

Anisa Haxhiaj
Avokate/ këshilltare paraligjore
TLAS



Histori e vërtetë 2

Rasti i klientes M.B, e cila i përket komunitetit rom është një nga rastet më të ndërlikuara të paraqitura dhe të suksesshme të TLAS, të trajtuara gjatë këtyre viteve.

Klientja ka lindur dy fëmijë gjatë emigrimit të paligjshëm në Greqi në kushte tejet të vështira ekonomike dhe jashtë institucioneve shtetërore pa patur asnjë kontakt me mjekët, për shkak edhe të frikës së autoriteteve greke dhe përzënies nga ai shtet.

E vetmja rrugë për të arritur këtë ishte rruga gjyqësore sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile dhe ligjin për gjendjen civile. Procesi gjyqësor ishte i vështirë dhe kërkoi një sërë provash jo të drejtëpërdrejta që të vërtetonin faktin e lindjes së fëmijëve të M.B si vërtetime prej mjekut të qendrës shëndetësore të lagjes, ku jeton klientja, vërtetim prej kryeplakut, i cili vërteton pasi njeh banorët e zonës, që ai mbulon, dëshmitarë, të cilët asistuan M.B në lindjen e fëmijëve. Në fund të procesit

gjyqësor pas shumë seancave, gjykata pranon kërkesën dhe vërteton faktin e lindjes së fëmijëve. Por ky vendim nuk ishte i plotë dhe i saktë, pasi gjykata nuk ishte shprehur saktësisht pasi në vendim nuk përmbaheshin të gjitha të dhënat themelore të fëmijëve, që mund të përfshihen në regjistrin e gjendjes civile, në vendim përfshiheshin emri, ditëlindja, seksi, mëmësia dhe mungonte vendlindja e fëmijëve. Vendlindja konsiderohet si e dhënë e rëndësishme sipas ligjit për gjendjen civile dhe zyra e gjendjes civile nuk mund të realizojë regjistrimin e fëmijëve në këto regjistra duke patur si mungesë këtë të dhënë.

Gjykatës iu drejtua me një kërkesë tjetër, së cilës i kërkohej ndreqja e gabimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në bazë të nenit 312 i Kodit të Procedures Civile, gjykata duhet të ndreqte pasaktësinë e dukshme të vendimit të dhënë, pasi ky vendim përmbante pasaktësi dhe është i vështirë për t'u zbatuar prej kërkuases.

Ky vendim përmbante pasaktësi të dukshme në lidhje me një përbërës të gjendjes civile sic është vendlindja e fëmijëve. Sipas ligjit nr. 8950 dt 10.10.2002 "Për gjendjen civile" përbërësit e gjendjes civile janë: emri, mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, seksi, raportet mëmësi dhe atësi, vdekja etj. Mungesa e kësaj të dhëne e bën këtë vendim të pazbatueshëm prej zyrës së gjendjes civile dhe si rrjedhim fëmijët nuk mund të regjistroheshin në këto regjistra. Pas shumë seancave të tjera



gjyqësore, të cilat zgjatën më tepër se një vit, në fund gjykatë pranoi kërkesën e dytë për ndreqjen e gabimit të vendimit të vërtetimit të faktit të lindjes së fëmijëve, duke e korigjuar lidhur me vendlindjen e fëmijëve të klientes, në bazë të thënies të dëshmitarëve të pranishëm në lindje dhe të provave të tjera jo të drejtëpërdrejta të paraqitura në gjykatë.

Të dy fëmijët u regjistruan në regjistrat e gjendjes civile me të dhënat e plota të kërkuara prej ligjit, atyre u lind mundësia të kërkojnë çertifikata personale prej kësaj zyre dhe të përfitojnë si individë të regjistruar prej të drejtave ligjore të garantuara prej shtetit tonë.

Anisa Haxhiaj
Avokate/ këshilltare paraligjore
TLAS

Studentët e TLAS vazhdojnë misionin e tyre...

TLAS është një ndër organizatat e cila angazhon në veprimtaritë e saj një grup të madh studentësh nga Fakulteti i Drejtësisë dhe ai i Punës Sociale, në kuadër të programit internship. Ky grup studentësh merr pjesë në një aktivitet shumë të rëndësishëm që janë pikërisht aktivitetet e formës Street Law (ndërgjegjësimi ligjor i publikut). Këto aktivitete organizohen për të rritur nivelin e ndërgjegjëimit publik për të drejtat e njeriut dhe çështjet ligjore e sociale. Tashmë sikundër dhe është bërë një praktikë e njohur pune, studentët udhëtojnë nëpër zona të ndryshme të vendit duke ofruar informacionin e nevojshëm për shërbimet e zyrës nëpërmjet shpërndarjes së publikimeve të përgatitura nga stafi i TLAS dhe bisedave që ne kryejmë me ata.

Në sajë të këtij bashkëpunimi të sukseshëm, një ndër aktivitetet e fundit bashkangjitur me aktivitetin Street law të zakonshëm që zhvillohet nga ne, ishte pikërishtë plotësimi i pyetësorëve që kishte për synim matjen e nivelit të kënaqësisë së publikut për shërbimet e ofruara nga Zyrat e Gjendjes Civile.

Plotësimi i këtyre pyetësorëve u realizua në praktikë pikërishtë nga studentët e TLAS-it. Ai u realizua në katër qytete të ndryshme të Shqipërisë si në Tiranë, Durrës, Fier dhe në Elbasan. Plotësimi i tyre u krye pranë Zyrave të Gjendjes Civile të këtyre qyteteve ku dhe vetë numri i qytetarëve që kërkonin të merrnin shërbim ishte i madh.

Qëllimi i pyetësorit “Matja e nivelit të kënaqësisë së publikut për shërbimet e ofruara nga Zyrat e Gjendjes Civile” konsistonte në marrjen e një informacioni sa më të gjerë nga qytetarët mbi llojin e shërbimit të kërkuar, mënyrën e marrjes së tij, nëse janë vonuar apo jo në marrjen e shërbimit të kërkuar



dhe cilat kanë qënë arsyet e vonesës së këtij shërbimi etj. Në fund të çdo pyetësori shtrohej një pyetje subjektive lidhur me faktin se çfarë do të dëshironte qytetari të ndryshohej apo të përmisohej në Zyrat e Gjendjes Civile dhe në shërbimet e ofruara prej tyre.

Në total numri i formularëve të plotësuar ishte 280, nga të cilat në Tiranë janë realizuar 160, në Durrës 40, në Elbasan po 40 dhe së fundmi në Fier u plotësuan 40 formularë.



Më date 12 janar 2009 aktiviteti Street law u zhvillua pranë Zyrës së Gjendjes Civile nr 3 dhe nr 4 në qytetin e Triranës. Përveç Street law bënë edhe plotësimin pyetësorëve që kishin si qëllim matjen e nivelit të kënaqësisë së qytetarëve për shërbimet që marin nga kjo zyrë, qytetaret u treguan shumë të gatshëm dhe sipas tyre te tillë pyetësorë për të matur kënaqësinë e qytetarëve kundrejtë shërbimeve publike që ato marin janë me shumë interes për ta. Ata kryesisht nuk ishin

shumë të kënaqur me shërbimin, kushtet e pritjes (infrastruktura), radhet e gjata në të cilat ishin të detyruar të prisnin etj

Street law i radhës u zhvillua pranë Komunës së Levanit ne qytetin e Fierit, me date 13 janar 2009. Banorët e kësaj zone ishin shumë të interesuar për shërbimet që ofronte zyra. Gjate ketij aktiviteti dhe takimi nga afer me ta vume re se problemet më të mprehta të tyre të cilat i mbulon edhe zyra jonë ishin: regjistrimi i lindjeve, zgjidhja e martesave, pretendimet për të marrë asitencë ekonomike etj. Përveç kësaj ishim edhe në zyrën e gjendjes civile për plotësimin e pyetësorëve "Per Gjëndjen Civile" me qëllim matjen e kënaqësie së komunitetit atje rreth shërbimeve që ofrojnë ata. Në pergjithësi komuniteti ishte i kënaqur me shërbimet qe merrnin , ku patjetër kishte vend për përmirësime.

Me datë 14 janar 2009, Street Law u zhvillua në lagjen "5 Maji " dhe në Labinot. Përvec aktiv-

itetit Street Law që zhvillojmë zakonisht, studentët plotesuan, me ndihmën e qytetarëve që ndodheshin pranë Zyrës së Gjendjes Civile në lagjen "5 Maj" dhe në Labinot. Pavarësisht kushteve të këqija atmosferike qytetarët ishin të gatshëm në plotësimin e formularëve. Ajo që vihej re në pamje të parë ishin kushtet e papërshtatshme në të cilën duhet të prisnin për të marrë shërbimet e nevojshme në këto zyra. Pakënaqësia e tyre lidhej me ambjentet, mungesën e profesionalizmit të punonjësve, punën e ngadaltë të punonjësve, radhët e gjata etj, gjë që e shprehën shumë mirë edhe gjatë plotësimit të pyetësorëve. Qytetarët dhanë mendimet e tyre sesi sipas tyre mund të përmirësoheshin kushtet në zyrat e gjendjes civile. Disa nga idetë e tyre ishin: kualifikimi i punonjësve, mënyra e komunikimit të jetë më etike, përmiresim i kushteve të infrastrukturës etj. Më datë 16 janar 2009 aktiviteti Street Law u zhvillua pranë Komunës Qendër Çlirim në qytetin e Fierit. Aktiviteti ishte i suksessh-

shëm dhe informacioni i shpërndarë ishte me interes për banorët e kësaj zone. Përveç kësaj shkuam edhe në zyrën e gjendjes civile për plotësimin e pyetësoreve "Për Gjendjen Civile", qytetarët u treguan shumë të gatshëm të bashkepunonin. Ajo që ne vume re dhe që më pas ata e shprehën gjatë plotësimit të pyetësoreve ishte se ata ishin shumë të kënaqur me shërbimet që merrnin pranë kësaj zyre.





Ajo çka ne vumë re gjatë këtyre aktiviteteve dhe që u prit shumë mirë nga ne ishte gatishmëria e qytetareve për të bashkepunuar, gjë që na e lehtësoi shumë punën gjatë këtyre aktiviteteve.

Anila Alliu
Nertila Bulku
Studente të Programit Internship
TLAS



Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

Nr. 1 / 2009

TLAS

